



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT DHE BORXHIT PUBLIK
DREJTORIA E ANALIZAVE DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

Nr. 11466 Prot.

Tiranë, më /.../06/2018

Lënda: Ftesë për pjesëmarrje në takimin konsultues me fokus diskutimin e përparësive dhe politikave në Programin Buxhetor Afatmesëm 2019 - 2021

MINISTRISË SË _____

INSTITUCIONI QENDROR _____

Të nderuar,

Në zbatim të nenit 25 të ligjit 9936/2008 i ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e projektit të Asistencës Teknike të BE-së për Mbështetjen e Strategjisë së Financave Publike dhe Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, me anë të kësaj shkrësë ka nderin t'ju ftojë për pjesëmarrje në një tryezë konsultimi për diskutimin e përparësive dhe politikave në Programin Buxhetor Afatmesëm 2019 - 2021 ditën e mërkurë, **20 qershor 2018 nga ora 9.30 – 13.00 tek Hotel Tirana International.**

Ky takim ka për qëllim diskutimin me pjesëmarrës të shoqërisë civile të prioritetëve të qeverisë të reflektuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm për ciklin e ardhshëm të buxhetit.

Përfaqësuesit në këtë takim duhet të jenë të nivelit të lartë menaxherial. Duke shpresuar në angazhimin tuaj maksimal, kërkojmë garantimin e pjesëmarrjes në këtë takim të rëndësishëm, i cili kontribuon në rritjen e transparencës në kuadër të një buxhetimi sa më gjithëpërfshirës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

